




REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS-SHTIME
Nr.01-060/01-13784/21 datë:17.06.2021



Npi – 01/180 datë: 28.06.2021

Duke u bazuar në nenin 12 pika (d) të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës" Nr. 28/2008); Nenit 13.1 pika (a) dhe neni 13.3 të Rregullores Komunale për ndarjen e Bursave për Studentë 01Nr.06/570-60 të datës, 30.03.2012, Kuvendi i Komunës në mbledhjen e mbajtur më: 28.06.2021, aprovoi këtë:

V E N D I M

**PËR ZGJEDHJEN E KOMISIONIT PËR NDARJEN
E BURSIVE PËR STUDENTË**

I

Kuvendi i Komunës së Shtimes, në mbledhjen e -VI- të rregullt për vitin 2021, të mbajtur më: 28.06.2021, me shumicën e votave aprovoi Vendimin për zgjedhjen e 2 (dy) anëtarëve të Komisionit nga Kuvendi, për ndarjen e Bursave për Studentë, për vitin akademik 2020/2021, nga gjithsejtë 5 (pesë) anëtarë sa është paraparë me rregullore, si vijon:

II

Dy anëtarë të Komisionit nga Kuvendi sipas nenit 13.1 pika (a) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, Nr.01/06/570-60 dt. 30.03.2012, u zgjedhën:

1. z.Herolind Selmani..... (Përfaqësues i pozitës)
2. z.Fehmi Hysenaj.....(Përfaqësuese e opozitës)

III

Dy anëtarë të Komisionit nga Ekzekutivi, sipas nenit 13.1 pika (b) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, me numër 01Nr.06/570-60 dt. 30.03.2012, i ka emëruar Kryetari i Komunës, me vendimin Nr.02/ ____ të datës ____ .06.2021 si vijon:

3. z.Fatmir Zymeri (Zyrtar për Arsim)
4. znj.Ardita Ndrecaj.....(Zyrtare e Personelit)

IV

Një anëtar të Komisionit nga OJQ-të, sipas nenit 13.1 pika (c) e Rregullores Komunale për ndarjen e bursave për Student, 01Nr.06/570-60 dt. 30.03.2012, e dërgojnë përfaqësuesit e Studentëve ose shoqërisë civile, si vijon:

5. z.Resul Gashi(Kryetar i Qendrës Rinore - Përfaqësues i OJQ-ve)

V

Vendimi u dërgohet: Arkivit, Anëtarëve të komisionit, Drejtorisë për Arsim, Kryetarit të Komunës, Ministrisë të Pushtetit Lokal dhe Zyrës për Informim.



Kryesuesja e Kuvendit
Medina Brahaj